



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 785, Datë 25.03.2021

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Hapja e hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003);  
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, “Mbi vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për vitin 2021”, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë”,

**VËREN SE :**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. 315 prot, datë 10.03.2021, me lëndë, “Mbi verifikimin e konstatimeve në shkelje të konkurrencës në procedurën e prokurimit” (protokolluar pranë AK me nr. 134 prot., datë 10.03.2021), ka paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës konstatimet e bëra mbi disa shkelje të konkurrencës në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, MK me afat 12 muaj, ndarë në 5 lote.
2. Në vijim të procedurave të prokurimit të lartpërmendur, KPP me vendimin nr. 209/4 prot, datë 11.03.2021 dhe vendimin nr. 228/5 prot, datë 11.03.2021 (vendime këto të cilat i janë përcjellë edhe AK-së, si subjekt i interesuar) ka vendosur:
  - a) Të pezullojë shqyrtimin administrativ të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë M.C.Catering SHPK dhe Eagle Cons SHPK, për procedurën e

prokurimit me objekt Loti I: “Blerje mish vici, mish pule dhe vezë”, me fond limit 39,274,333 lekë pa TVSH, dhe objekt Loti IV: “Blerje artikuj ushqimor”, me fond limit 36,178,027 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.01.2021 nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë; si dhe

- b) T'i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e bëra, si dhe të informojë KPP-në në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.
3. Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, si dhe KPP, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, vihet re se:
- Operatori Eagle Cons SHPK (anëtar i bashkimit të operatorëve Eagle Cons SHPK dhe Eraldo 2013 SHPK) me operatorin ekonomik M.C.Catering SHPK, ofertues në të njëjtin lot, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët;
  - Në deklaratat e të dy operatorëve rezulton se, personat në cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të operatorëve respektiv (Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK), janë motër e vëlla;
  - Ofertat e këtyre dy ofertuesve kanë një diferencë të vogël ndërmjet tyre;
  - Të dy operatorët ekonomikë, ofertues në të njëjtin lot, kanë autorizuar të njëjtin person për të kryer kampionimin e mostrave pranë ISUV;
  - Gjithashtu nga verifikimi i mostrave të paraqitura nga këta ofertues, rezulton se nga 22 artikuj të këtij loti, për 16 artikuj janë paraqitur mostra të njëjta nga të dy operatorët ekonomikë. 16 mostrat e paraqitura nga të dy operatorët ekonomik kanë të njëjtin emërtim, prodhues dhe të njëjtën datë skadence;
  - Në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se për artikullin “Rigon i tharë”, dokumentacioni që lidhet me raportin e provës për këtë artikull, i paraqitur nga operatori ofertues M.C.Catering SHPK, të jetë në emrin e operatorit Eagle Cons SHPK, ofertues në të njëjtin lot.
4. Sa më sipër ngrihen dyshime të arsyeshme se dërmarrjet M.C.Catering SHPK dhe Eagle Cons SHPK përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili prej tyre do të paraqesë ofertën më të lartë dhe cili ofertën fituese në procedurën e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, duke krijuar përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të sinqertë.
5. Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, kjo sjellje hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të ushqimeve të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

6. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit të ushqimeve të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, ka elementë të një sjelljeje antikonkurruese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.
2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**